



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 506/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie Morina Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.506/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 fletëvotim në Vendvotimin 2408A//03D, të shpallet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar, i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.506/2019, nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 22.11.2019, gjatë ndërrimit të parë të punës (08:00-16:00), në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit të votave në kutinë e votimit 2408A/03D, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores Zgjedhore 06/2013. Në kutinë 2408A/03D, në të cilën gjendet fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja “TIK”, në katrorin e subjektit politik me nr. 134, dhe një “shkrim-votim” me shenjën “V” e cila është vendosur përkrah hapësirës së subjektit politik me nr. 111, dhe ky fletëvotim është shpallur i vlefshëm, e që vërehet qartë se mban shenjat si me sipër. Sipas ankuesit një veprim i tillë bie në kundërshtim me Doracakun e KQZ-së, shtojca 8, duke kërkuar nga PZAP-i që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ-QNR, që këtë fletëvotim ta largojë nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar.

Lidhur me pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ankesës i ka bashkangjitur një mostër të fletëvotimit të pavlefshëm sipas Doracakut të KQZ-së, shtojca 8 dhe një kopje të fletëvotimit nr.2408A/03D.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 23.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson se fletëvotimi është shpallur i vlefshëm për arsye se shihet qëllimi i qartë i votuesit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit 2408A/03D, nga ana e QNR-së, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim, në të cilin votuesi përveç se ka votuar për subjektin politik me nr. 134, i njëjti ka vendosur përkrah hapësirë së subjektit politik me nr. 111, një “shkrim-votim” me shenjën “V”, dhe megjithatë QNR-ja me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD , me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm dhe të njëjtën të mos e përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të shpallur me 07.10.2019

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se një fletëvotim i gjetur në kutinë e votimit 2408A/03D, pa të drejtë është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbushë asnjërin kriter të vlefshmërisë, andaj i njëjti duhet të llogaritet si i pavlefshëm dhe duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar më datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Siç edhe qëndron ne dispozitivin e këtij VENDIMI, Fletëvotimi i shpallur i vlefshëm, duhet të largohet nga rezultati i publikuar përfundimtar i datës 07.11.2019, te cilin fletëvotim e gjeni te bashkangjitur me këtë vendim.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 506/2019 më datë 24.11.2019

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



ZGJEDHJE
P1

29024/637
40 100

ZYNDARJE E REPARIMIT SË KOSOVËS 2019
QINDRË REPUBLIKË KOSOVË 2019

1 Shifra e VETËM NË shtetësi të cilat
Detyrojnë SAMO JEDAN parti të ndajshme

2 Shifra të reparaimit të shtetësisë
Detyrojnë MËNJEKË parti të ndajshme

- 111. PARTIA LIBERALE E EQIPTANË - PLE
- 112. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- 113. PARTI E ASHKALINJEVERË PËR INTEGRIM - PAI
- 114. STRANAKA DEMOKRATSKË AKCIJE - SDA
- 115. PARTIJA KOSOVSkih SRBA - PKS
- 116. PARTIJA DEMOKRATIKE E ASHKALINJEVERË PËR KOSOVËS - PDAK
- 117. POKRET ZA GORA - PG
- 118. NOVA DEMOKRATISKA STRANAKA - NDS
- 119. AAK - PËR PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- 120. SLOBODA
- 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANAKA - SLS
- 122. NISMA SOCIALDEMOKRATË E ALENKA KOSOVA E RE JA PARTIJA E DREJTËSISË
- 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124. V KOALICIJA VAKAT
- 125. FJALA
- 126. LEVIZIJA VETËVENDOSJEI
- 127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KOTP
- 128. PARTIA ROMË E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIJA - KNRP
- 131. INICIATIVË E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- 132. ESMIR KASI
- 133. GRADANSKA INICIATIVË GORE - GIO
- 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- 135. SRPSKA LISTA

1	3	3	4
5	6	7	8
9	10	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		